

Data 03.07.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR  
KUALIFIKIM

*(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)*

OBJEKTI I PROCEDURËS: Mbështetje për Programin Operacional 2025-2028: Shërbime Konsulence, Projektimi dhe Mbikëqyrje për Investimet e Programit IVR.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 73300000-5; 71247000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: **116,952,709.93 lekë** pa TVSH, **Euro 1,239,299.67**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe”, autoriteti/enti kontraktor FSHZH ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3;*
- b. *Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 10.*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 41, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik."

## 2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare, **2023, 2024, 2025** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e marrëveshjes kuadër në procedurën e prokurimit.

*Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar.

*Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare". AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrisë së Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: "Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata."

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet **financiare 2023, 2024, 2025** të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në nenin 41, pika "b", të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku bilancet e dy viteve nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

*Për operatorët e huaj, në rastet kur në vendin e origjinës nuk lëshohen dokumentet e kërkuara për të vërtetuar bilancet/pasqyrat financiare apo xhiron vjetore, mund të paraqesin një deklaratë për konfirmin e tyre .*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 61 të ligjit nr. 29/2023, datë 30.3.2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimi i Përgjithshëm i Ministrit të Financave nr.26, datë 8.9.2023, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar: “Çdo person, që i nënshtrohet këtij ligji, është i detyruar të deklarojë në organin tatimor të gjitha të ardhurat, qofshin ato të tatuara në çfarëdo mënyre apo të përjashtuara nga tatimi. Për personat fizikë që janë nën 18 vjeç deklarata tatimore bëhet nga kujdestari i tyre ligjor. 2. Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njësisve ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël”.*

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

## 2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më të vogël se 30% e vlerës së përllëgaritur të marrëveshjes kuadër. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës ose/dhe

faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41 pika 3 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Ky kriter vërteton eksperiencën në fushën objekt prokurimi me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Përvoja e operatorit është një element i nevojshëm për autoritetin, për të vërtetuar qendrueshmërinë ekonomike të ofertuesit, eksperiencat dhe besueshmërinë në përmbushjen e sukseshme të kontratës. Në kuptim të nenit 41 te VKM-se 285/2021 vlerësohet vlera e kërkuar në masen jo më të vogël se 30 % të vlerës së përlogaritur të marrëveshjes që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. e cila është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës rrjedhimisht nuk sjellë kufizim të pjesëmarrjes në garë të operatorëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme për projekttime dhe mbikëqyrje të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë sipas përcaktimit në vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.2016”. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me shërbimin e projektimit duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

#### **i- Licensat e kerkuara ne projektim:**

- 2 a,b-3,d: Projektim arkitekturor për objekte banimi - objekte industriale - objekte turistike Objekte spitalore, terminallet në infrastrukturë, vepra arti në infrastrukturë-Projektim peizazhi, sistemim sipërfaqe të gjelbra, lulishte e parqe
- 3 a,c-2: Projektim objekte civile – industrial – turistike, prej murature dhe skelet beton arme deri ne 5 kate  
Troje dhe shpate me qendrueshmeri te ulet
- 4 a,b,c,g,f,i,j: Projektim të instalimeve hidro-termosanitare  
Projektim të instalimeve termoteknike-kondicionimi, si dhe të impianteve të prodhimit të energjisë termike nga burime të rinovueshme, Projektim të linjave e rrjeteve elektrike, për objekte civile e industriale, projektim të sistemeve kundra zjarrit  
Projektim të sistemeve të monitorimit dhe automatizimit në industri dhe ndërtesa

Projektimi i ndriçimit rrugor, shesheve, dekorativ, ndriçimit të objekteve të mëdha sportive, porteve aeroportive etj.

Projektim të rrjeteve të telefonisë, citofonisë, fonisë, internetit, TV, access controll, CCTV, sistemet e alarmit, sistemet e dedektimit të zjarrit etj., për objektet civile e industriale.

- 5 c,d: Projektim vepra hidraulike, ujesjelles e kanalizime urbane-rurale Vepra ujitje - kullimi - impiante vaditëse - diga të vogla (ato që nuk plotësojnë kushtin e digave të mëdha) - damba, sifona, kaskada, kapërderdhëse, rrymëshpejtues, priza, baraze, porta, tombino.
- 6 a,b: Projektim rrugë lokale, rrugë urbane dytësore dhe rrugë interurbane dytësore
- 7 a,b: Projektim rruge urbane kryesore dhe rrugë interurbane kryesore
- 8 a,b: Ura dhe vepra arti të vogla deri më 10 m-dhe vepra arti mbi 10m.  
Rilevime inxhinerike  
Rilevime inxhinerike kadastrale.
- 9 a,d: Studim gjeologo-inxhinerik i truallit për objekte deri 5 kate Studim/vlerësim gjeologo-inxhinierik i trojeve të buta dhe shpateve me qëndrueshmëri të ulët.
- 10 e: Projektim kabina elektrike në rrjetin shpërndarës - linja të tensioni të ulet – të mesëm.
- 11 a: Sinjalistikë jondricuese në rrugë lokale, urbane dytësore, rrugë interurbane dytësore, sheshe dhe parkim.
- P/A/1 Projektim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike
- P/A/5 Projektim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
- P/A/7 Projektim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe).

Specialisti i mjedisit duhet te zoteroj certifikate ne perputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti operatori ekonomik duhet te paraqese licensen e shoqerise.

## **ii-Liçensat e kërkuara në mbikëqyrje**

- N.P – 1. Punime gjermimi në tokë.
- N.P – 2. Ndërtime civile e industriale.
- N.P – 3. Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
- N.P – 4. Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
- N.P – 5. Punime nëntoksore, ura e vepra arti.

- N.P – 7 a. Ujësjiellësa, gazsjiellësa, vajsjiellësa, vepra kullimi e vaditje.
- N.P – 10. Ndërtimi i impiantevë për prodhimin e energjisë elektrike.
- N.P – 11. Ndërtime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- N.P – 12. Punime të inxhinierisë së mjedisit.

**iii-Për mbikëqyrjen e punimeve speciale të ndërtimit Operatori Ekonomik duhet të ketë licencat e mëposhtme:**

- N S – 1. Punime për prishjen e ndërtimeve
- N S – 2. Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre.
- N.S – 3. Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë levizëse, transportues)
- N S – 4. Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik, xhami dhe rifiniture të natyres teknike ndërtuese.
- N.S – 8. Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
- N S – 9. Punime strukturore speciale.
- N.S – 10. Shtresa dhe mbistruktura speciale.
- N S – 12. Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionit.
- N S – 13. Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.
- N S – 14. Impiante të brëndshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV
- N.S – 18. Punime topogjeodezike
  
- MK/A/1 Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike
- MK/A/5 Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare)
- MK/A/7 Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane;

*Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (VKM nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim).*

-Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar nenin 41, pika 4, gërma a) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, vendimin nr.759, datë 12.11.2014 të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikqyrjes e koaludimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, ndryshuar me VKM-në nr.943 datë 28.12.201”, si dhe VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënie, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale” dhe teknikisht në Termat e Referencës sipas tipologjisë së objekteve kulturore. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve objekt të kontratës të lëshuara nga autoritetet kompetente. Licencat janë të lidhura ngushtësisht me objektin e kontratës shërbimin e projektimit dhe të mbikqyrjes. Sa i përket shërbimit të projektimit Kategorite e mesiperme janë përcaktuar në përputhje me Termat e Referencës dhe tipologjinë e projekti. Ndërkohë për shërbimin e mbikqyrjes se punimeve në zbatim kategorite e mesiperme janë përcaktuar në përputhje me Termat e Referencës dhe natyrës së kontratës.

2.3.3 Operatori Ekonomik ose bashkimi i Operatoreve Ekonomike duhet të paraqesin një listë të stafit kryesor të mëposhtem, të cilët duhet të kenë një marrëdhënie kontraktore me operatorin apo partnerin në rastin e një bashkimi operatorësh. I gjithë stafi kryesor i kërkuar duhet të jetë i licensuar në shërbimet e projektimit dhe mbikqyrjes si dhe duhet të zotërojnë licencat profesionale sipas kategorive të renditura më sipër, përkatesisht për specialitetin që mbulojnë. Për çdo pozicion, operatorët janë të lirë të propozojnë më shumë se një kandidat, me qëllim përmbushjen e kriterëve të kërkuara.

**i)-Pozicionet e stafit kryesor të kërkuar janë:**

Tabela për stafin

<b>Stafi për shërbimin e projektimit dhe mbikqyrjes</b>	<b>Stafi i projektimit</b>	<b>Stafi i mbikqyrjes</b>	<b>Total</b>
Drejtuues Projekti (Drejtuues i grupit të projektimit) Projektues (arkitekt/inxhinier ndërtimi/konstruktor etj, me përvojë në varesi të projekteve specifike)	1		1
Arkitekt	1	1	2
Projektues Konstruktor	1	1	2
Projektues Instalator	1	1	2
Projektues Rrugësh	1	1	2
Projektues Hidroteknik	1	1	2
Projektues Elektrik	1	1	2
Projektues Gjeodet	1	1	2
Projektues Gjeolog	1	1	2
Specialit Mjedisi	1	1	2

Kontrollor Cilesie		1	1
Kontrollor i volumeve te punes		1	1
Inspektor të sigurimit dhe Shëndetit në punë (HSE)		1	1
<b>Total</b>	10	12	22

**ii) Licensat qe duhet te zoteroje stafi kryesor i projektimit:**

Drejtues Projekti (Drejtues i grupit te projektimit)	*
Arkitekt	2 a,b-3,c,d;
Projektues Konstruktor	3 a,c-2;
Projektues Instalator	4 a,b,c,f,g i,j;
Projektues Hidroteknik	5 c,d;
Projektim Rruge	6 a,b;
Projektues Gjeodet	8 a,b;
Projektues Gjeolog	9 a,d;
Projektues Elektrik	10 e;
Projektues te sinjalizimit rrugor	11 a;
Projektues per nderhyrje ne pasurite kulturore materiale	P/A/5; P/A/7.
Specialisi i Mjedisit	Specialisti i mjedisit duhet te zoteroj certifikate ne perputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020

- Drejtues Projekti\* (Projektues rruges/ Arkitekt/ Projektues Konstruktor/ Projektues hidroteknik), duhet të jetë pjese e stafit të shoqërisë dhe të figurojnë në listëpagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhen 3 (tre) mujore te fundit nga data e zhvillimit të tenderit.
- Operatori ekonomik do duhet që në çdo kantier të ketë një Inxhinier Rezident (per mbikeqyrjen).

Stafi i mësipërm duhet të jetë pjesë e stafit të propozuar për të ndjekur projektin dhe implementimin e punimeve. Për të vërtetuar plotësimin e këtij kushti, për secilin prej specialistëve të lartpërmendur Operatorët Ekonomike duhet të paraqesin:

-kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme

\* *Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr.10 "Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese.*

-Argumentimi: Referuar në nenin 41 pika 4/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Për shërbimet sipas përshkrimit në Termat e Referencës, shërbimet e projekteve teknike të detajuara të objekteve - Infrastrukturë dhe zhvillim urban, konektivitetit, rrugë dhe ura, furnizim me energji elektrike, rrjete telefonike dhe teknologji informacioni, rikualifikimit të shesheve urbane, mobilimit urban, parkime mbi tokë dhe nën tokë, infrastrukturave urbane, shëtitorë dhe fasada, peisazhe, mbrojtje nga erozioni detar, erozioni lumor, trajtime ujrash-Trashëgimisë kulturore, restaurime të monumenteve të kulturës apo objekte të tjera të trashëgimisë kulturore, realizimin e muzeve (bashkohore apo trashëgimi kulturore), galeri arti, arrredim/interiere dhe/ose muzealizim., gjykojmë se duhet të kryhet nga një staf profesional i kompletuar me njohuri për fushat specifike dhe eksperiencën e mjaftueshme, për të garantuar kompletimin e standardeve në fushën përkatëse. Përcaktimi i stafit teknik për projektimin është bazuar tek elementet e produkteve të përcaktuara në termat e referencës. Kategoritë e licencave bazohen në parashikimet e VKM-së nr.759/2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes së kolaudikimit të punimeve të zbatimit në ndërtim miratuar kriteret teknike dhe profesionale të kualifikimit”. Për të dokumentuar eksperiencën e stafit kryesor, Drejtuesi Projektit (Projektues rruges, Arkitekt, Projektues Konstruktor, Projektues hidroteknik), që zënë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkojnë si dokument justifikues listepagesat e punonjesve të shoqërisë për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit. Sa i përket kërkesës për specialistin e mjedisit është e nevojshme që gjatë fazës së zbatimit të kontratës duhet të raportojë pranë autoritetit kontraktor për masat e marra për mbrojtjen e mjedisit nga ndikimet negative të veprimtarisë, për këtë qëllim subjekti duhet të jetë i certifikuar në përputhje me Ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 i ndryshuar me Ligjin 128/2020. Specialisti i mjedisit është një kërkesë e vendosur nisur dhe nga rëndësia e objekteve dhe volumi i punimeve sipas standardeve të kushteve teknike.

Sa i përket kërkesës për Projektues për nderhyrje në pasuritë kulturore materiale, kriteri bazohet në VKM Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale” dhe teknikisht në Termat e Referencës sipas tipologjisë së objekteve kulturore.

Kërkesa për stafin teknik për shërbimin e mbikëqyrjes lidhet ngushtësisht me numrin e objekteve të kontratës së zbatimit dhe vendndodhjen e tyre. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit dhe bazuar në VKM nr. 610, datë 22.9.2022. Numri i stafit kryesor teknik për mbikëqyrjen është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës, me qëllim për të patur një rezultat sa më të mirë dhe cilësor në

mbarëvajtjen dhe mbikeqyrjen e punimeve. Stafi teknik i inxhinierëve, kapacitetet dhe aftësitë organizative janë të domosdoshëm gjatë mbikeqyrjes së objekteve. Drejtuesi teknik është përgjegjës për mbikeqyrjen sipas projektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit dhe brenda kushteve të kontratës

Për të dokumentuar eksperiencën përvojën e stafit kryesor /profesional që zë pjesën më të rëndësishme të punës, gjykojmë të kërkojmë kualifikimet arsimore (diplomat), kualifikimet profesionale (licencat profesionale), CV, Kontratë pune të vlefshme.

2.3.4. Numri i punonjësve: Numri i punonjësve të siguruar duhet të jetë jo më pak se 10 (dhjete) punonjës për çdo muaj, për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, ndërsa stafi tjetër mund të jetë me kontratë shërbimi.

- Për të vërtetuar këtë kusht, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën për periudhën 3 (tre) mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, i cili duhet të përputhet me listë pagesat e punonjësve për këtë periudhë e vërtetuar kjo me listëpagesat përkatëse të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve;

\*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 10. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatit të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

-Argumentim: Kërkesa është vendosur në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur duke u bazuar në shërbimet e kërkuara sipas Termave të referencës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje tre mujore të fundit nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë listë pagesat e shoqëruara me formularët e deklarimit të pagesave shoqërore dhe shëndetësore me këtë kohështrirje është

dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

3. Mbështetje subjektive nuk lejohet për kriteret e mëposhtme:

-Për të provuar përvojën e mëparshme (shërbime të ngjashme):

Pika 2.3.1 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

-Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale (licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës):

Pika 2.3.2 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”

Argumentimi ligjor: Në mbështetje të Nenin 84, pikat 6 dhe 7 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar; Nenin 88, Neni 90, pikat 5 dhe 6 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” Nuk lejohet mbështetja në kapacitetet e subjekteve të tjera sipas pikës 2.16 të DST-ve.

Argumentimi teknik: Autoriteti Kontraktor për zbatimin dhe realizimin e objektit me sukses dhe cilësi do të gjykojë mbi përvojën e mëparshme të operatorit i cili do të zbatojë këtë kontratë dhe jo në përvojën e një operatori tjetër, i cili i mbështet thjesht për t’u kualifikuar por nuk merr përsipër të kryej asnjë shërbim gjatë zbatimit. Do ishte një vlerësim jo korrekt nga ana e autoritetit nëse do lejonte mbështetjen në përvojë të ngjashme dhe operatori i cili do të fitonte kontratën nuk do të kishte përvojën e duhur, si dhe për më tepër të mbajë përgjegjësi për mos përmbushje të kontratës. Në rastin e një bashkimi operatorësh kërkesat për kualifikim, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuaranë aktmarrëveshje. Gjithashtu, lejimi i mbështetjes në subjekte të tjera përbën një risk shumë të madh për zbatimin e kontratës dhe përfundimin e saj me standard dhe cilësi. Licenca është dokument juridik e profesional, që i jep të drejtë disponuesit të saj të ushtrojë veprimtari të caktuar, sipas kriterëve të licencave. Duke u nisur nga këto fakte, gjykojmë se një operator ekonomik nuk do të realizonte me sukses zbatimin e kontratës në qoftë se nuk do të dispononte pikën e licencës për atë kategori dhe përvojën e ngjashme. Gjithashtu, ju bëjmë me dije se AK nuk kufizon mundësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë për të përmbushur këto kriterë.

### **Argumentimi i Termave të Referencës**

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit*

publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

*Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

Termat e referencës janë hartuar sipas standardeve dhe në përputhje me perkatimet ligjore në fuqi dhe janë pjesë e pandare e DST. Termat e Referencës përcaktojnë hapat për ofrimin e shërbimit të konsulencës në projektim dhe mbikëqyrje, me qëllim garantimin e cilësisë, përputhshmërisë me legjislacionin në fuqi dhe realizimin korrekt të projektit.

Ndërhyrja parashikohet të mbështesë zbatimin e Programit Operacional për periudhën 2025-2028 përmes financimit të shërbimeve teknike dhe procedurale të nevojshme për realizimin e investimeve të planifikuara. Paketa synon të mundësojë maturimin e projekt-ideve dhe të kërkesave të identifikuar në projekte të zbatueshme, në përputhje me standardet teknike, kërkesat e planifikimit dhe nevojën për garantimin e cilësisë së investimeve publike.

Shërbimet e projektimit dhe mbikëqyrjes do të përcaktohen në fazën e II-të të minikonkurseve dhe jo domosdoshmërisht do të përfshihen të gjitha shërbimet e cituara. Në fazën e minikonkurseve paketat do të përcaktohen sipas nevojës së shërbimit që kërkohet për fazë specifike, paketat mund të cilësohen në: projektim (ku mund të përfshihen të gjitha fazat dhe/ose pjesërisht) dhe/ose mbikëqyrje dhe/ose të kombinuara (projektim + mbikëqyrje).

#### **B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

**Në rastin e marrëveshjes kuadër, kur do të përdoret kriteri i vlerësimit të çmimit për njësi, për qëllime krahasimi, vlerësimi i ofertave të paraqitura do të bëhet në bazë të shumatores së çmimeve për njësi** (Kjo, metodë vlerësimi nuk do të përdoret nga autoritetet/entet kontraktore kur sasi të janë të llogaritshme në bazë vjetore, sipas eksperiencës së mëparshme, dhe kur marrëveshja kuadër përdoret për prokurimin e mallrave dhe shërbimeve të vazhdueshme. Në këtë rast, çmimi i ulët do të vlerësohet me vlerën totale më të ulët të ofruar).

Çmimi (në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit).

### **B.1 Faza 1- (Kualifikimi/ Marrëveshja Kuadër)- Projektim, Mbikëqyrje**

Per kete fazë, kriteret e perzgjedhjes se operatoreve ekonomik pale ne marreveshjen kuader, do te jete, çmimi kërkesat e përgjithshme dhe të vecantat të kualifikimit

*(Çmimi në përputhje me kërkesat e VKM nr.354 datë 11.5.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim të territorit) (jo me te vogel se tarifa minimale sipas VKM 354/2016), kërkesat e përgjithshme dhe te veçanta per kualifikim.*

### **B.2 Faza 2 – Minikonkursi - (Projektim, Mbikëqyrje ose Projektim & Mbikëqyrje)**

Për këtë fazë kriteret e përzgjedhjes së fituesit do të indentifikohet në bazë të kostos per sipas natyres sëkontratës/ave të shërbimit., Autoriteti Kontraktor ne fazen e minikonkursit do te perfshije ne ftesen per oferte kriteret e perzgjedhjes së kontratës fituese:

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit jane si me poshte:

#### **B) oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim X**

Sipas rëndësisë me rends zbrates, si më poshtë:

<b>1. Çmimi</b>	<b>pikët 50</b>
<b>2. Propozimi teknik</b>	<b>pikët 50</b>
(i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar	0 - 20
(ii) Metodologjia e Propozuar (Përqasja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)	0 - 10
(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme të Konsulentit	0 - 20

#### **1.1 Kriteri Çmimi**

**[50] pike**

Kriteri i cmimit me 50 pikë është i bazuar ne rregullat e prokurimit publik, ku parashikohet minimalisht 50 pike.

Vlerësimi i Propozimeve Ekonomik kryhet sipas formulës së mëposhtme:

Pe - Pikët për Propozimin Ekonomik

Çu - Çmimi më i Ulët i Ofruar

Ç - Çmimi Ofertues i Radhës (duke filluar nga çmimi më i ulët)

$$Pe = 100 \times \frac{\text{Çu}}{\text{Ç}}$$

(çmimi më i ulët = pikët maksimale për propozimin ekonomik)

*Argumentimi: Kriteri i mësipër është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", te ndryshuar*

## **2.2 Kriteri Propozimi teknik [50] pike**

Vlerësimi i Propozimeve Teknike kryhet duke marrë parasysh kriteret e mëposhtme:

**i) Kualifikimet e Stafit Kryesor të Propozuar / Projektim, Mbikëqyrje, Projektim dhe Mbikëqyrje [0- 20]**

### **Nenkriteret**

Numri i pikëve që do të vendoset për çdo pozicion apo specialitet duhet të përcaktohet duke marrë në konsideratë nënkriteret e mëposhtme dhe peshën përkatëse në përqindje:

a- Kualifikim i përgjithshëm për projektim, mbikëqyrjen [ 5-20 %]

b- Eksperienca në fushën përkatëse projektim, mbikëqyrje [30-80 %]

Kualifikimi i përgjithshëm përfshin: arsimimin përkatës dhe trajnimet, vitet e eksperiencës.

Eksperienca në sektorin specifik, fushën përkatëse, të lidhura këto me pozicionin e përcaktuar në stafin kryesor.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

- *Stafi i kërkuar në pikën 2.3.4, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.*

**Argumentimi:** Kriteret e mësipërme janë përcaktuar bazuar në Nenin 45, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Operatori Ekonomik për t’u vlerësuar për këte kriter duhet të provojë se zotëron merita teknike, aftësi organizimi, kualifikimi dhe përvojën e stafit që është emëruar në eksperiencat e mëparshme të ngjashme në kryerjen e punimeve. Kriteri është vendosur për të treguar organizimin, kualifikimin dhe përvojën e stafit, ku cilësia e stafit të emëruar mund të ketë një ndikim domethënës në nivelin e zbatimit të kontratës.

**ii) Metodologjia e Propozuar / Projektim, Mbikëqyrje, Projektim dhe Mbikëqyrje [ 0 – 10]**

(Përfaqja teknike dhe metodologjia, plani i punës, aftësia organizative)

### **Nenkriteret**

ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia [10-30%]

ii/b Plani i punës dhe grafiku i dorëzimit të projekti/objekt [30-40%]

ii/c. Organizimi i Stafit [10-30%]

**ii/a. Përfaqja teknike dhe metodologjia:** Konsulenti duhet të shpjegojë që i ka kuptuar objektivat e detyrës së dhënë në Termat e Referencës, përfaqjen teknike, metodologjinë për të realizuar aktivitetet e

ndryshme, duke përfutur rezultatet e pritura dhe shkallën e detajimit të këtyre rezultateve. Konsulenti duhet të paraqesë problemet kryesore dhe rëndësinë e tyre dhe të shpjegojë përjasjen teknike që do të adaptojnë për zgjidhjen e tyre. Konsulenti duhet të shpjegojë metodologjinë që propozon të adoptojë dhe të paraqesë kompatibilitetin e këtyre metodologjive me qërjasjen e propozuar (konsulenti në këtë rast nuk duhet të përsërisë/kopjojë Termat e Referencës).

**ii/b. Plani i Punës dhe grafiku i dorëzimit të projektit/objektit:** Konsulenti duhet të propozojë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Gjithashtu, duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkret. Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull.

**ii/c. Organizimi dhe Staffi:** Konsulenti duhet të përshkruajë kompozimin dhe strukturën e skuadrës së tij, listën e ekspertëve kryesore, stafin mbështetës, CV e firmës dhe personelin ekonomik-administrativ.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit sipas nënkritereve të mësipërme.

**Argumentimi:** *Kriteret e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 45 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Metodologjia që ndiqet për realizimin e projekteve ka për qëllim të përfshijë aktivitetet kryesore të detyrës, përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e dorëzimit të projektit, fazat dhe ndërlidhjen midis tyre, etapat e dorëzimit të raporteve dhe projektit. Plani i propozuar i punës duhet të përputhet me përjasjen teknike dhe metodologjinë, duke treguar se i ka kuptuar kërkesat e Termat e Referencës në plan pune konkret. Metodologjia duhet të tregojë aftësinë për t'i transformuar kërkesat e Termave të Referencës në plan pune konkrete. Përmbanë menaxhimin dhe përgjegjësitë kryesore të grupit të zbatimit të projektit Një listë e dokumentave përfundimtare përfshirë raportet, vizatimet dhe tabelat të cilat duhen dorëzuar, duhet përfshirë në këtë kapitull*

*Metodologjia që ndiqet për realizimin e mbikëqyrjes së punimeve synon të garantojë cilësinë e ndërtimit të objektit, të kontrollojë cilësinë e materialeve që do të përdoren në objekt referuar me specifikimet teknike të projektit, kontrollin e zbatimit të grafikut të punimeve, kontrollin sasior të volumeve të preventivit, si dhe zgjidhjen e problemeve teknike apo organizative që dalin gjatë zbatimit të punimeve në objekt. Metodologjia do të ketë një rol të rëndësishëm në zbatimin e projektit. Metodologjia prezanton gjithashtu detyrat dhe strukturën organizative të grupit të zbatimit të punimeve.*

**(iii) Përvoja për Punë të Ngjashme të Projektuesit/ Mbikqyresit [0 – 20]**

Nënkriteret

**iii/a Përvoja për punë të ngjashme projektues, mbikëqyrës 40-80%**

Operatorët ekonomikë, të vlerësohen sipas kontratave të sukseshme të ngjashme me objektin e prokurimit.

**iii/b. Kapaciteti ekonomik dhe certifikatat e standardeve të cilësisë 10-20%**

Operatorët ekonomikë të vlerësohen sipas kapacitetit ekonomik dhe certifikatave të standardeve të cilësisë së paraqitur në ofertë.

Në çdo rast, anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në mënyrë individuale duhet të argumentojnë dhe dokumentojnë lidhur me mënyrën e pikëzimit, sipas nënkritereve të mësipërme.

**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 79 të ligjit 162/2020, Referuar në nenin 79 parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë” dhe nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Certifikata e standardeve të cilësisë lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.*

Formula që zbatohet për llogaritjen e pikëve është si më poshtë:

$$Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$$

Po - janë pikët totale të ofertës së vlerësuar Pk1/Pk2/Pk3/... - janë pikët për çdo kriter të vlerësuar

Pikët për çdo kriter përlllogariten sipas formulës:

$$Pk1 = V_{min} k1 \times P_{max} k1 / Ok1$$

Pk1 \_\_\_\_\_ Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{min} k1$  Vlera e më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{max} k1$  Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

Ok1 Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Oferta më e mirë  $Po = Pk1 + Pk2 + Pk3 + \dots$

Piket dhe pesha e vendosur për secilin nënkriter gjatë zhvillimit të fazës së minikonkursit, do të variojnë brenda kufijve të përcaktuar më sipër.